

**Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) në Kosovë**

**PROCEDURAT E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE 2026-2028**

**Qershor 2025**

**Këto Procedura të përcaktimit të Tarifave janë përgatitur për procesin e përcaktimit të tarifave për periudhën 2026-2028 dhe zëvendësojnë dokumentet e mëparshme të procedurave të përcaktimit të tarifave të zbatueshme për përcaktimet e mëparshme të tarifave. Këto procedura do të mbeten të vlefshme për përcaktimet e ardhshme të tarifave që i nënshtrohen ndryshimeve siç kërkohet nga ARRU.**

**Misioni**

“Shërbime cilësore, të sigurt dhe efíciante të shërbimeve të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

**Vizioni**

“Rregullimi i sektori i ujit në mënyrë transparente dhe të paanshme, në përputhje me praktikat e mira evropiane, që siguron që ndërmarrjet e ujësjellësit të ofrojnë një shërbim cilësor, të qëndrueshëm, të besueshëm dhe të përballueshëm në tërë territorin e Kosovës, duke respektuar si mjedisin ashtu edhe shëndetin publik.”

**Përmbajtja**

Preambula .....1

Dokumentet shoqërues të rëndësishëm .....1

Përkufizimet dhe akronimet .....3

**1 Historiku, procesi dhe korniza e përgjithshme .....5**

    1.1 Ndryshimet kryesore në procedurat e zhvilluara për përcaktimin e tarifave për periudhën 2012-2024 5

    1.2 Procesi i përcaktimit të tarifave .....5

    1.3 Obligimet dhe objektivat.....6

**2 Pasqyra e përcaktimit të tarifave dhe koncepteve .....7**

    2.1 Platforma e modelit për përcaktimin e tarifave .....7

    2.2 Burimet e të dhënave hyrëse.....7

    2.3 Koncepti i përgjithshëm i përcaktimit të tarifave .....7

    2.4 Pasqyra e kërkesës për të ardhura .....7

    2.5 Kategoritë dhe aktivitetet e shërbimeve .....8

    2.6 Shpenzimet operative .....8

    2.7 Investimet kapitale dhe kategorizimi i aseteve .....9

    2.8 Shpenzimet për investime kapitale – mirëmbajtja kapitale e infrastrukturës.....9

    2.9 Shpenzimet kapitale për investime – përmirësimi i infrastrukturës.....10

    2.10 Shpenzimet kapitale për asete joinfrastrukturore.....10

    2.11 Ndikimi i investimeve kapitale në tarifa.....11

2.12	Grantet dhe kontributet kapitale për investime .....	12
2.13	Tarifat për përforcimin e infrastrukturës .....	13
2.14	Baza rregullatore e asetëve (BRRRA) .....	13
2.15	Kthimi nga baza rregullatore e asetëve .....	14
2.16	Pajtimi i investimeve aktuale dhe atyre të planifikuara në të kaluarën (rikthimi i investimeve) .....	14
2.17	Shitjet e ujit për përcaktimin e tarifave të bazuara në vëllim .....	14
2.18	Strukturat e tarifave .....	15
<b>3</b>	<b>Metoda e përcaktimit të tarifave .....</b>	<b>15</b>
3.1	Kërkesa për të ardhura .....	15
3.2	Çmimet reale.....	15
3.3	Shqyrtimi i propozimeve nga ARRU .....	16
3.4	Llogaritja dhe përcaktimi i tarifave .....	16

### Figurat

Figura 1 – Ndikimi i investimeve në kërkesën për të ardhura për investime joinfrastrukturore.....12

Figura 2 – Ndikimi i investimeve në kërkesën për të ardhura për investimet infrastrukturore.....12

### Kontrolli i ndryshimeve

Versioni i rishikimit	Miratuar	Detajet e ndryshimeve
01	ZRRUM 25/05/2011	Veroni i parë për KRU-të
02	ARRU 06/05/2025	Rishikim i thellë pas konsultimit të janarit 2024 dhe vendimeve të ARRU-së të janarit 2025
0.3	ARRU 27/06/2025	Insertimi i seksionit për procedurat e tërheqjes së investimeve të aprovuara dhe të përealizuara

## Preambula

Ky dokument përcakton procedurat që duhet të ndiqen nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) për paraqitjen e tarifave të tyre të kërkuara për furnizimin me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura për periudhën 2026-2028, duke përfshirë dhe ato për kërkesat e ardhshme. Paraqitja e tarifave bazohet në kornizën e planifikimit afarist të KRU-ve, ku tarifat duhet të jenë të mjaftueshme për të financuar aktivitetet dhe nivelet e performancës siç janë përcaktuar në Biznes Planin Rregullator. Pas një procesi të kontrollit rregullator, nivelet përfundimtare të rëna dakord të performancës do të bëhen më pas zotime të performancës në këmbim të miratimit të tarifave nga ARRU që janë përcaktuar të jenë të mjaftueshme për përmbushjen e këtyre objektivave. Performanca e ardhshme e KRU-ve do të matet kundrejt këtyre zotimeve të performancës.

E rëndësishme në këto procedura është përcaktimi i kalendarit rregullator, i cili përcakton afatin kohor të detajuar për kërkesat e informacionit, kërkesat, konsultimet dhe proceset e miratimit. Është e rëndësishme që ARRU dhe KRU-të të veprojnë në përputhje me këtë program të planifikuar për të përmbushur afatet e veçanta për tarifën e reja që do të aplikohen. Informacioni i kërkuar për raportimin periodik duhet të përdorë përkufizime të ngjashme si në këto procedura për të monitoruar në mënyrë efektive performancën reale kundrejt supozimeve të bëra në rishikimin e tarifave dhe për të reduktuar mundësinë për duplikime të panevojshme dhe keqinterpretim.

Zbatimi i këtyre procedurave varet plotësisht nga sigurimi i informacionit të nevojshëm nga KRU-të në formatin e planit afarist të përcaktuar nga ARRU. Në këtë rishikim, ky informacion është i detyrueshëm pasi procesi i llogaritjes së tarifave është një komponent i pandashëm i modelit të planit rregullator afarist. Dështimi për të ofruar informacionin në formatin e përcaktuar do ta bëjë paraqitjen e tarifave pa fuqi juridike dhe të pavlefshëm.

Ky rishikim i *Procedurave të Tarifave*, ka për qëllim të pasqyrojë ndryshimet dhe përmirësimet e fundit në procesin e përcaktimit të tarifave, pas konsultimit publik, të mbajtur në janar të viti 2024 dhe vendimeve rregullatore të mëposhtme që u janë komunikuar KRU-ve në janar 2025. Këto përfshijnë:

- Heqjen e përshpejtuar të ndër-subvencioneve.
- Prezantimin e tarifave fikse, bazuar në madhësitë e ujëmatësve.
- Prezantimin e tarifave për përmirësimin e infrastrukturës jashtë vendit.
- Prezantimin e tarifave për ujërat e ndotura të vlerësuara, kur gjenerimi i ujërave të ndotura nuk lidhet me konsumimin e ujit nga KRU.
- Prezantimin e tarifave për ujërat e ndotura, për të pasqyruar cilësinë e ujërave të ndotura për konsumatorë të veçantë jo-shtëpiakë.
- Tarifat duhet të pasqyrojnë pritshmëritë e arsyeshme për reduktimin e humbjeve të dukshme.
- Tarifat duhet të pasqyrojnë kompensimin për konsumatorët për investime të përfshira në rishikimet e mëparshme, por jo të realizuara.

Ky rishikim i *Procedurave të Tarifave* hyn në fuqi për periudhën e rishikimit të tarifave 2026-2028 dhe më pas do t'i nënshtrohet ndryshimeve të mëtejshme sipas nevojës.

## Dokumentet shoqërues të rëndësishëm

Këto *Procedura të Tarifave* duhet të lexohen së bashku me dokumentet e mëposhtme:

- Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (i ndryshuar)
- Politika e Rishikuar e Tarifave të ARRU-së (prill 2025)
- Rregulli i ARRU-së për Përcaktimin e Shërbimeve të Tarifave për Ujin, Ujërat e Ndotura dhe Furnizimin me Ujë në Kosovë (2012, i ndryshuar) [do të ndryshohet për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028]
- Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (V1 2025)
- Udhëzuesi i Përdoruesit për Biznes Planin Rregullator dhe Modelin e Tarifave (Versioni 2, 2011) [do të ndryshohet për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028]
- Konsultimi i ARRU-së mbi politikën e ardhshme të tarifave për furnizimin me ujë, janar 2024
- Raporti i ARRU-së për përgjigjet ndaj konsultimit mbi politikën e ardhshme të tarifave për furnizimin me ujë, prill 2024

Ky dokument i rishikuar i *Procedurave të Tarifave* është zhvilluar për të mbështetur vendimet e fundit rregullatore që u janë komunikuar KRU-ve nëpërmjet letrave të dërguara në dhjetor të vitit 2024, pas konsultimit lidhur me:

- Përmirësimin e informacionit të Planit të Biznesit, të bazuar në prova të verifikueshme
- Tarifat fikse- bazuar në madhësinë e kycjes
- Tarifat për ujërat e ndotura industriale dhe udhëzimet shoqëruese
- Humbjet e ujit- që do të merren parasysh në përcaktimin e tarifave të ardhshme
- Kthimin nga Baza Rregullatore e Aseteve (BRRA)
- Tarifat e vlerësuara të ujit
- Heqjen e ndër-subvencionimit.
- Rimbursimin e parave të paguara nga konsumatorët për investimet që nuk janë realizuar.
- Tarifat për përforcimin e rrjetit dhe udhëzimet shoqëruese

## Përkufizimet dhe akronimet

**Humbjet e dukshme:** Konsumimi që nuk regjistrohet, për shkak të gabimeve në ujëmatës dhe konsumatorëve të paregjistruar.

**Shërbimi bazë:** Niveli aktual i shërbimit, përtej të cilit kërkohet investim kapital shtesë, për përmirësimin e shërbimit dhe/ose shpenzimet shtesë operative (pas përmirësimeve të efijencës).

**Modeli Tarifor i Aseteve Kapitale:** Një mjet ekonomik konvencional që përdoret nga rregullatorët për të përcaktuar kthimin nga kapitali që ndërlidhet me rrezikun për sektorin specifik që do të rregullohet.

**Kontributet kapitale:** Kontributet financiare të bëra nga konsumatorët aktualë ose të ardhshëm ose zhvilluesit për aktivitete specifike të investimeve kapitale që lidhen me kërkesat e tyre specifike.

**Mirëmbajtja kapitale:** Puna e planifikuar e realizuar nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit për të zëvendësuar dhe riparuar asetet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura për të siguruar një shërbim bazë për konsumatorët.

**Akumulimi i mirëmbajtjes së kapitalit:** Mirëmbajtja kapitale shtesë për të kompensuar për vitet e kaluar kur mirëmbajtja kapitale nuk është realizuar. Kjo mirëmbajtja kapitale e akumuluar është një përmirësim në nivelin e shërbimit dhe konsiderohet si shpenzim për përmirësim dhe shtohet në BRRRA.

**Kompensimi:** procesi përmes të cilit bëhen rregullime në kërkesën për të ardhura për të kompensuar konsumatorët për investimet që janë përfshirë në rishikimet e mëparshme të tarifave, por që nuk janë realizuar.

**Tarifat për kyçje:** Tarifa për konsumatorin ose zhvilluesin e projektit ndërtimor për të mbuluar kostot e kyçjes në rrjetin kryesor të konsumatorëve.

**Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK):** Indeksi për matjen e inflacionit të konsumatorëve, i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

**Rikuperimi i kostos:** Kërkesa për të ardhura që është e mjaftueshme për të financuar aktivitetet e ofruesve të shërbimeve, plus një kthim të arsyeshëm nga kapitali që ata kanë investuar, duke ofruar ende një shërbim në përputhje me kërkesat e tyre ligjore dhe rregullatore.

**Reflektueshmëria e kostos:** Koncepti ku çmimet për konsumatorët individualë ose grupet e konsumatorëve duhet, sa më praktikisht të jetë e mundur, të pasqyrojnë kostot që këta konsumatorë individualë ose grupe të konsumatorëve ia imponojnë ofruesit të shërbimeve.

**Ndër-subvencionimi:** Një rregullim çmimesh ku një ose më shumë grupe të konsumatorëve paguajnë një çmim më të lartë, për shërbimet e tyre - për të subvencionuar çmimet për një ose më shumë grupe të tjera të konsumatorëve.

**Kontabiliteti i kostos aktuale:** Një metodë e kontabilitetit që paraqet transaksionet dhe raporton vlerat e tyre aktuale. Në vend që të shfaqen asetet sipas kostos së tyre historike (p.sh. çmimi i blerjes fillestare), minus zhvlerësimi, ku është e përshtatshme, asetet shfaqen sipas kostos së tyre aktuale (kostoja e zëvendësimit) në momentin e krijimit të llogarive. Kjo metodë e kontabilitetit përdoret në industrinë e ujit për shkak të natyrës së gjerë të aseteve kapitale dhe faktit që, kostot historike, nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë të aseteve.

**Zhvlerësimi i kostos aktuale:** Zhvlerësimi i llogaritur në përputhje me metodat e kontabilitetit të kostos aktuale.

**Niveli ekonomik i rrjedhjeve:** Niveli i rrjedhjeve në një sistem ku kostot e reduktimit të mëtejshëm të rrjedhjeve tejkalojnë përfitimet që do të realizohen nga reduktimi i rrjedhjeve.

**Përmirësimi:** Përmirësimi dhe zgjerimi i bazës së aseteve përmes nivelit të përmirësuar të shërbimeve dhe/ose zgjerimit të sistemit.

**Tarifat fikse:** Komponenti i strukturës tarifore që është një shumë fikse për muaj, pavarësisht nga vëllimi i ujit të konsumuar ose ujërave të ndotura të shkarkuara.

**Grantet:** Financimi i ofruar për investime ose ofrimin e shërbimeve për të cilat nuk kërkohet kthim. Investimi në infrastrukturë i financuar nga grantet nuk i shtohet as tarifës së rinovimit të infrastrukturës dhe as bazës rregullatore të aseteve.

**Asetet infrastrukturorë:** Asetet (kryesisht asetet nëntokësore), që nuk kanë një jetëgjatësi të kufizuar dhe të cilat, nëse mirëmbahen siç duhet, do të jenë në gjendje të vazhdojnë të ofrojnë një nivel të paracaktuar shërbimi për klientët për një kohë të pacaktuar.

**Tarifa për rinovimin e infrastrukturës:** Një dispozitë vjetore kontabël për shpenzimet - për rinovimin e aseteve infrastrukturorë (d.m.th. kryesisht nëntokësore), që ngarkohet në llogarinë e fitimit dhe humbjes rregullatore.

**Ligji:** Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (i ndryshuar) themelon Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) si rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të ndotura.

**Formula Mogden:** Formula e miratuar ndërkombëtarisht për përcaktimin e tarifave për ujërat të ndotura industriale bazuar në cilësinë e shkarkimit të ujërave të ndotura.

**Asetet joinfrastrukturorë:** Kryesisht asetet sipërfaqësore, siç janë impiantet e trajtimit të ujit, stacionet e pompimit, labororet, depot dhe punëtoritë e kompanisë.

**Tarifat për përforcimin e infrastrukturës:** Tarifat për zhvilluesit e projekteve ndërtimore për të mbuluar kostot kumulative të përmirësimit të rrjetit, të shkaktuar nga pronat e tyre të reja.

**Shpenzimet operative:** Shpenzimet e drejtpërdrejta operative, lidhur me ofrimin e shërbimit, duke përfshirë fuqinë punëtore; energjinë; kimikatat; materialet shpenzuese; shpenzimet e përgjithshme; taksat e pakthyeshme dhe shpenzimet tjera të përsëritura.

**Periodha e kontrollit të çmimeve:** Periudha (zakonisht tri vjeçare) gjatë së cilës do të zbatohet rishikimi i tarifave.

**Humbjet reale:** Humbjet e ujit në rrjet i atribuohen rrjedhjeve fizike në tubacione.

**Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR):** Rregullat e kontabilitetit të përcaktuara nga ARRU, për regjistrimin e transaksioneve financiare, në atë mënyrë që është në përputhje me procedurat dhe modelin e përcaktimit të tarifave.

**Baza rregullatore e asetëve (BRR):** Baza e kapitale që përdoret për përcaktimin e kufijve të çmimeve. Përfaqëson vlerën fillestare të investimeve të bëra dhe borxhit, kapitalit qarkullues, kapitalit e qeverisë dhe shpenzimet e reja kapitale neto. Vlera e bazës rregullatore të asetëve llogaritet pasi të bëhet zhvlerësimi i kostos aktuale dhe rregullohet sipas inflacionit në secilën periudhë të re të rishikimit të çmimeve.

**Kthimi mbi BRR:** Një kthim i drejtë nga baza rregullatore e asetëve, i paraqitur si të ardhura vjetore dhe rritje e kapitalit nga investimi, e shprehur si përqindje e investimit fillestar.

**Kërkesa për të ardhura (KA):** Të ardhurat vjetore të nevojshme për të financuar aktivitetet e KRU-ve, duke përfshirë kthimin nga kapitali. Ajo përfshin kostot operative; tarifën për rinovimin e infrastrukturës; zhvlerësimin e kostos aktuale; kthimin nga BRR dhe kostot tjera sipas rastit.

**KRU:** Kompania Rajonale e Ujësjellësit, e rregulluar nga ARRU.

**Procedurat e Përcaktimit të Tarifave:** Procedura e detajuar e llogaritjes së tarifave, për përcaktimin e tarifave gjatë periudhës së caktuar të kontrollit të çmimeve.

**Përcaktimet e tarifave:** Një proces ku ARRU përcakton tarifën për periudhën e specifikuar të shqyrtimit të tarifave në përputhje me rregullat dhe procedurat e specifikuar.

**Tarifat e ndryshueshme:** Komponenti i strukturës tarifore që bazohet në një normë për njësi për m<sup>3</sup> ujë të konsumuar.

**ARRU:** Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, rregullatori ekonomik i emëruar për sektorin e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimit në Kosovë.

## 1 Historiku, procesi dhe korniza e përgjithshme

### 1.1 Ndryshimet kryesore në procedurat e zhvilluara për përcaktimin e tarifave për periudhën 2012-2024

- 1.1 Politikat, procedurat, modeli dhe informacionet tjera mbështetëse për përcaktimin e tarifave janë përdorur që nga rishikimi i tarifave për periudhën 2012–2014, me modifikime minimale. Megjithëse këto mjete rregullatore i kanë shërbyer mirë Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) dhe kompanive rajonale të ujësjellësit (KRU), ARRU ka vlerësuar se ishte i domosdoshëm një rishikim i thelluar. Ky rishikim kishte për qëllim të merrte parasysh zhvillimet e reja në sektor në Kosovë, komentet nga KRU-të dhe faktorët tjerë.
- 1.2 Në janar të vitit 2024, ARRU ka ndërmarrë një konsultim me qëllim që të marrë nga të gjithë palët e interesit mendimet e tyre lidhur me propozimin e ARRU-së për përmirësim. Këto kanë përfshirë:
- Zëvendësimin e tarifës fikse mujore- me dy nivele (shtëpiake dhe jo-shtëpiake), me një tarifë fikse më reale, sa i përket kostos, të bazuar në madhësinë e kyçjes.
  - Përsheptimin e heqjes së ndër-subvencionimit nga konsumatorët jo-shtëpiake në favor të konsumatorëve shtëpiake.
  - Një mekanizëm, përmes të cilit, konsumatorët kompensohen në mënyrë efektive, përmes tarifave të ardhshme, për investimet e përfshira, në përcaktimet e tarifave që nuk janë realizuar.
  - Masat për përmirësimin e planifikimit afarist dhe paraqitjes së dokumentacionit për përcaktimin e tarifave, përmes kërkesës për dëshmi mbështetëse, veçanërisht për programin e investimeve, kryesisht për të adresuar problemin e investimeve të propozuara por të përealizuara.
  - Prezantimin e tarifave për përmirësimin e infrastrukturës për zhvilluesit, në mënyrë që të kontribuohet në financimin e përfundimit të rrjetit në rrjedhën e sipërme (ujë) dhe rrjedhën e poshtme (ujëra të ndotura), që shkaktohet nga efekti kumulativ i zhvillimeve të reja. Kjo do të rezultojë me tarifa pak më të ulëta për konsumatorët shtëpiake sesa në rastin kur ato do të ishin ndryshe.
  - Prezantimin e tarifave për ujërat e ndotura të vlerësuara, në rastet kur sasia e ujërave të ndotura të gjeneruara nuk reflekton sasinë e ujit të furnizuar nga KRU.
  - Prezantimin e tarifave për ujërat e ndotura të bazuara në cilësinë e tyre, në rastet kur cilësia e ujërave të ndotura është dukshëm ndryshe nga cilësia mesatare e ujërave të ndotura.
- 1.3 Rezultatet e konsultimit, kanë qenë kryesisht pozitive, dhe shumica e propozimeve janë pranuar në metodologjinë e re për përcaktimin e tarifave. Në disa raste, veçoritë e reja janë opsionale dhe KRU-të individuale mund të kërkojnë përjashtim nga kërkesat përkatëse, nëse vlerësojnë se ato nuk zbatohen për to dhe/ose përfitimet janë minimale.
- 1.4 Këto kërkesa të reja janë përshkruar në letrat që u janë dërguar KRU-ve në janar 2025, para publikimit të mjeteve të rishikuara për përcaktimin e tarifave.
- 1.5 Kërkesat tjera, që nuk janë përfshirë në konsultim, u janë komunikuar gjithashtu KRU-ve në janar 2025, në veçanti nevoja që KRU-të të ndërmarrin masa për kontrollin e humbjeve të tyre (të dukshme dhe reale) në nivelet e tyre ekonomikisht eficiente. Kjo përfshin edhe pritshmërinë e arsyeshme për reduktimin e humbjeve të dukshme që do të përfshihet në modelin për përcaktimin e tarifave.
- 1.6 Këto procedura të reja pasqyrojnë propozimet dhe vendimet e ARRU-së.

### 1.2 Procesi i përcaktimit të tarifave

- 1.7 Aktivitetet kryesore dhe afatet e tyre në lidhje me procesin e përcaktimit të tarifave janë paraqitur Tabela 1 më poshtë.

**Tabela 1 – Procesi rregullator, aktivitetet kryesore dhe afatet**

Afati	Aktiviteti	Përgjegjësia	
		KRU	ARRU
31 korrik (viti bazë-1)	Konsultimi dhe përgjigjet për pozicionin e përcaktimeve tarifore	●	●
31 janar (viti bazë)	Vendimet e ARRU-së pas konsultimeve dhe përgjigjeve.		●
31 maj (viti bazë)	Nxjerrja e modelit të rishikuar për përcaktimin e tarifave dhe dokumentacionit mbështetës. Të mbështetura me punëtorë dhe aktivitete të tjera trajnuese.		●
30 gusht (viti bazë)	Dorëzimi i planeve të biznesit, propozimeve për tarifa dhe informacionit mbështetës.	●	
31 tetor (viti bazë)	Shqyrtimi i propozimeve dhe publikimi i draft përcaktimeve të tarifave.		●
15 nëntor (viti bazë)	Afati për komente nga KRU-të lidhur me përcaktimet e draftit për tarifa	●	
30 nëntor (viti bazë)	Publikimi i nxjerrjes të përcaktimeve përfundimtare të tarifave. Publikimi i vendimeve për tarifën për vitin bazë +1 (me tarifa të përshtatura sipas normave të inflacionit).		●
1 janar (viti bazë +1)	Miratimi i tarifave të vitit bazë +1, të rregulluara sipas normave të inflacionit.	●	
30 nëntor (viti bazë +1)	Publikimi i vendimeve për tarifën për vitin bazë +2 (me tarifa të përshtatura sipas normave të inflacionit).		●
1 janar (viti bazë +2)	Miratimi i tarifave të vitit bazë +2, të rregulluara sipas normave të inflacionit.	●	
30 nëntor (viti bazë +2)	Publikimi i vendimeve për tarifën për vitin bazë +3 (me tarifa të përshtatura sipas normave të inflacionit).		●
1 janar (viti bazë +3)	Miratimi i tarifave të vitit bazë +3, të rregulluara sipas normave të inflacionit.	●	

### 1.3 Obligimet dhe objektivat

- 1.8 Këto procedura përshkruajnë propozimet e detajuara për përcaktimin e tarifave për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura. Ato bazohen në obligimet ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (i ndryshuar) (Ligji). Ato gjithashtu u përmbahen parimeve të politikës tarifore të rishikuar të ARRU-së (prill 2025).
- 1.9 Metodologjia për përcaktimin e tarifave është krijuar për të siguruar që KRU-të të mund të sigurojnë të ardhura të mjaftueshme nga tarifën, për të financuar siç duhet, aktivitetet e tyre, të përbëra nga kostot operative, mirëmbajtja e kapitalit dhe një kthim i arsyeshëm nga baza rregullatore e asetëve (BRRR).
- 1.10 Megjithëse metodologjia synon që KRU-të të financojnë aktivitetet e tyre, konsumatorët nuk duhet të pritet të financojnë efijencën. Metodologjia bazohet në pritshmëri reale, por megjithatë sfiduese, për përmirësime në efijencë. Në këtë drejtim, metodologjia e përcaktimit parashih që ARRU të shqyrtojë informacionin e dorëzuar nga KRU-të, për të vlerësuar nëse planet përfshijnë pritshmëritë për përmirësim të efijencës dhe për të siguruar që shpenzimet e parashikuara janë të justifikuar, me çmim të saktë dhe, veçanërisht në rastin e shpenzimeve për investime, me gjasë të lartë që do të realizohen. Ndryshe nga qasja e mëparshme për përcaktimin e tarifave, ku ky informacion kryesisht ishte pranuar si i mirëqenë, ARRU tani kërkon dëshmi të verifikueshme për të mbështetur aktivitetet dhe shpenzimet e përfshira në kërkesat për tarifa.
- 1.11 Kur ARRU vlerëson se aktivitetet dhe shpenzimet janë joefikase, të vështira për t'u justifikuar, të vlerësuar me çmim tepër të lartë ose nuk mbështeten nga dëshmi të besueshme, ARRU mund të ndryshojë të dhënat e kërkesës në përputhje me rrethanat. Në të kaluarën, ARRU ka shqyrtuar kërkesat nga të gjitha KRU-të dhe ka përdorur analizën statistikore për të krahasuar zërat e kostos për njësi me qëllim të udhëzimit të procesit të ndryshimit të kërkesave. Ky proces do të vazhdojë.
- 1.12 Pas shqyrtimit nga ARRU, ARRU do të publikojë draft përcaktimet e tij për shqyrtim nga KRU-të. KRU-të janë të lira të paraqesin mendimet e tyre dhe, pas shqyrtimit të duhur, ARRU do të publikojë përcaktimet përfundimtare me kohë që tarifën e reja të zbatohen deri më 1 Janar të vitit të parë të periudhës së kontrollit të çmimeve.

## 2 Pasqyra e përcaktimit të tarifave dhe koncepteve

### 2.1 Platforma e modelit për përcaktimin e tarifave

- 2.1 Modeli i mëparshëm i tarifave është zëvendësuar me një model të përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, që kap të gjitha ndryshimet që kanë rezultuar nga konsultimet dhe vendimet e mëvonshme të ARRU-së.
- 2.2 Modeli tani përfshin një fletë pune të vetme në MS Excel. Modeli përcakton kërkesat e të dhënave hyrëse nga të cilat përcaktohen të gjitha tarifat.

### 2.2 Burimet e të dhënave hyrëse

- 2.3 Të dhënat hyrëse që kërkohen në modelin e tarifave janë përgjegjësi e ekipeve të planifikimit të biznesit të KRU-së. Pritet që informacioni të vijë nga burime të ndryshme, duke përfshirë:
  - Projektionet e performancës dhe investimeve nga KRU: p.sh. projektionet e shitjeve, përmirësimet në rregullimin e konsumatorëve të rinj, aktivitetet e matjes (duke përfshirë vlerësimet për humbjet e ujit), projektionet e arkëtimit të të ardhurave, projektionet e kostove operative, planet e investimeve (duke përfshirë borxhet e akumuluar për mirëmbajtjen kapitale), pritshmëritë për shërbime të zgjeruara, kërkesat për mbulimin e borxhit (pagesat e interesit dhe kredisë), etj.
  - Llogaritë rregullatore: p.sh. baza e aseteve rregullatore, zhvlerësimi i kostos aktuale, rinovimet e infrastrukturës, etj.
  - Pasqyrat financiare të audituara (dhe jo të audituara) nga KRU-të: p.sh. deklaratat e detajuara të të ardhurave, regjistrat e aseteve, afatet e kredive, të dhënat e kosto-qendrave, raportet e performancës etj.
  - Vendimet dhe udhëzimet e ARRU-së: Kthimi nga kapitali, kushtet kufizuese, etj.
  - Burimet tjera: p.sh. statistikatat e inflacionit.

### 2.3 Koncepti i përgjithshëm i përcaktimit të tarifave

- 2.4 Kërkesa për të hyra përfaqëson të ardhurat, që KRU-të kanë nevojë për të financuar aktivitetet e tyre, duke përfshirë programet e investimeve. Ajo llogaritet në baza vjetore në terma real, në nivelet e çmimeve të vitit bazë. Pjesët kryesore të kërkesës për të ardhura janë:
  - Shpenzimet operative.
  - Shpenzimet për mirëmbajtjen e kapitalit, duke përfshirë rinovimin e infrastrukturës dhe zhvlerësimin e kostos aktuale.
  - Kthimin para tatimit, mbi bazën rregullatore të aseteve (BRR).
- 2.5 Koncepti i përcaktimit të tarifave, bazohet në përcaktimin e tarifave për çdo vit të periudhës së kontrollit të çmimeve, të cilat do të ofrojnë një rrjedhë të ardhurash, të barabartë me kërkesën për të ardhura.
- 2.6 Pas zbritjes së tarifave fikse, të ardhurave nga tarifa për kyçje dhe dispozitave të tjera që nuk lidhen me vëllimin, tarifat mesatare të, ujit të përcaktuara në baza vjetore për çdo vit janë kërkesat për të ardhura neto nga furnizimi me ujë pjesëtuar me vëllimin e pritur të shitjeve të ujit për atë vit. Sa i përket tarifës për ujëra të ndotura, ajo është kërkesa për të ardhura neto nga shërbimi i ujërave të ndotura, pjesëtuar me vëllimin e shitjeve të ujit, për ata konsumatorë që kanë qenë të kyçur në sistemin e ujërave të ndotura për atë vit.
- 2.7 Duke filluar nga viti 2029, kërkesa për të ardhura, do t'i nënshtrohet një rregullimi për rikthimin e ndikimeve tarifore, të aktiviteteve investuese, që janë përfshirë në rishikimet e mëparshme të tarifave, por që nuk janë realizuar. Kjo në fakt është rimbursim për konsumatorët, për investimet që ata kanë paguar, por që nuk janë realizuar.

### 2.4 Pasqyra e kërkesës për të ardhura

- 2.8 Shpenzimet operative, përfshijnë shpenzimet e parashikuara operative të shërbimit bazë dhe ndryshimet neto në shpenzimet operative, të lidhura me përmirësimet e cilësisë, zgjerimin e shërbimeve dhe ndryshimet në nivelin e shërbimit. Shpenzimet operative do të përfshijnë gjithashtu një ndarje të shpenzimeve të planifikuara të centralizuara dhe të përgjithshme.
- 2.9 Mirëmbajtja kapitale përfshin shpenzimet afatgjata, për ruajtjen e mundësive për shërbim të aseteve nëpërmjet riparimeve ose zëvendësimeve të mëdha. Kjo përfshin shpenzimet për rinovimin e infrastrukturës për asetet

nëntokësore (infrastrukturore) dhe dispozitën për zhvlerësimin e kostos aktuale për asetet mbitorësore (jo infrastrukturore).<sup>1</sup>

- 2.10 Kthimi nga kapital është kthimi nga baza rregullatore e asetëve (BRRRA). BRRRA përcaktohet nga vlera fillestare për çdo vit dhe shpenzimet pasuese kapitale që barten në BRRRA (përmirësimi i infrastrukturës, mirëmbajtja e kapitalit jo infrastrukturor dhe përmirësimi jo infrastrukturor) pas zhvlerësimit, heqjes nga përdorimi, grantet dhe kontributet, të indeksuar në nivelet e çmimeve të vitit bazë.
- 2.11 Shkalla e kthimit nga BRRRA do të përcaktohet nga ARRU. Duke filluar nga viti 2025, kthimi nga BRRRA do të përfshijë një bonus për gjashtë KRU-të më të vogla për të pasqyruar kostot e tyre më të larta të financimit.

## 2.5 Kategoritë dhe aktivitetet e shërbimeve

- 2.12 Shpenzimet operative dhe investuese të parashikuara do të regjistrohen se i përkasin njëres prej dy kategorive kryesore të shërbimeve të:
1. Furnizimit me ujë.
  2. Shërbimeve të ujërave të ndotura.
- 2.13 Shpenzimet për shërbimet e furnizimit me ujë ndahen në:
- a. Shpenzimet direkte që përfshijnë:
    - i. Burimet dhe trajtimin
    - ii. Shpërndarjen
  - b. Shpenzimet indirekte që përfshijnë:
    - i. Aktivitetet e centralizuara të biznesit (shërbimet për konsumatorët, shpenzimet e përgjithshme etj.)
- 2.14 Shpenzimet për shërbimet e ujërave të ndotura ndahen në:
- c. Shpenzime direkte të përbëra nga
    - i. Mbledhja e ujërave të ndotura
    - ii. Impianti për trajtimin e ujërave të ndotura
    - iii. Trajtimi dhe përpunimi i llumit
  - d. Shpenzimet indirekte që përfshijnë:
  - e. Aktivitetet e centralizuara të biznesit (shërbimet për konsumatorët, shpenzimet e përgjithshme etj.)

## 2.6 Shpenzimet operative

- 2.15 Shpenzimet operative të parashikuara neto nga grantet, do të barten në kërkesën për të ardhura. Nga KRU-të kërkohet të demonstrojnë se shpenzimet e parashikuara janë të arsyeshme dhe eficiente. ARRU do të shqyrtojë kërkesat dhe do të marrë parasysh përshtatjet në propozime kur ARRU konsideron se këto kritere nuk janë përmbushur<sup>2</sup>. Pozicioni i ARRU-së është se pa ndonjë ndryshim material në mjedisin operativ, përmirësimi i efijencës duhet të nënkuptojë që shpenzimet operative të njësisë (shpenzimet e trajtimit për m<sup>3</sup> të ujit të prodhuar, shpenzimet e rrjetit për km tubacioni dhe aktivitetet e biznesit për konsumator) duhet të bien në terma real me kalimin e kohës.
- 2.16 KRU-të kërkohet të justifikojnë rritjet reale të shpenzimeve operative për njësi, kur këto rritje janë përfshirë në projeksione. Kjo mund të rezultojë nga shpenzimet operative shtesë të nevojshme për të përmirësuar nivelet e shërbimit, p.sh. reduktimin e humbjeve të ujit dhe vënien në punë të objekteve të reja.
- 2.17 Projektionet e shpenzimeve operative mund të marrin në konsideratë pritshmërinë e ndryshimeve të njohura të çmimeve në të ardhmen për aq sa ato ka të ngjarë të ndikojnë në kërkesat e përgjithshme të të ardhurave të KRU-

<sup>1</sup> Llogaritja e kostos aktuale për qëllime të llogarive rregullatore është indeksimi i shpenzimeve, vlerave të asetëve dhe dispozitave për zhvlerësim në përputhje me indeksin e inflacionit të publikuar për Kosovën. Për përcaktimin e tarifave nuk aplikohet qasja alternative moderne e vlerave ekuivalente të asetëve (MVEA).

<sup>2</sup> Shqyrtimi mund të përfshijë analizën e regresionit linear statistikor për shpenzimet operative bazuar në shpenzimet për njësi të prodhimit të ujit për m<sup>3</sup> ujë të prodhuar, funksionimin e rrjetit për km tubacioni dhe aktivitetet e biznesit për konsumator. Kjo analizë përfshin përshtatjet për zërat e pazakontë të kostos, siç është kostoja për energji.

ve në raport me indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK)<sup>3</sup>. Këto rritje do të merren parasysh vetëm nëse ARRU i konsideron të mjaftueshme për të pasur ndikim material në qëndrueshmërinë financiare të KRU-ve.

- 2.18 Të ardhurat nga tarifat për kyçje konsiderohen si një kontribut në shpenzimet operative dhe duhet të zbriten nga kërkesa për të ardhura në përcaktimin e kërkesës neto për të ardhura.

## 2.7 Investimet kapitale dhe kategorizimi i asetëve

- 2.19 Në industrinë e ujit dhe ujërave të ndotura bëhet një dallim për qëllime rregullatore ndërmjet:

- **Asetet infrastrukturore:** Asetet që kanë një jetëgjatësi të dobishme të papërcaktuar dhe të cilat, nëse mirëmbahen në mënyrë adekuate, duke përfshirë zëvendësimin dhe riparimin e madh të komponentëve me kalimin e kohës (mirëmbajtja kapitale), mund të pritet të ofrojnë një nivel shërbimi për konsumatorët për një periudhë të pacaktuar. Këto asetë nuk i nënshtrohen zhvlerësimit. Në vend të kësaj, një tarifë për rinovimin e infrastrukturës (TRI) ofrohet në kërkesat për të ardhura dhe llogaritë rregullatore për të përfaqësuar mirëmbajtjen kapitale të funksionalitetit së asetëve nga biznesi gjatë vitit. Pasi këto asetë nuk janë subjekt i zhvlerësimit, vlera në BRRR ruhet përjetësisht. Investimi në përmirësimin e rrjetit, duke përfshirë zgjerimin e rrjetit, përmirësimet në nivelet e shërbimit, përmirësimet në cilësi dhe mirëmbajtjen e kapitalit të akumuluar shtohet në BRRR në vend që të barten si pjesë e TRI-së. Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR) ofrojnë detaje të mëtejshme mbi procesin e rinovimit të infrastrukturës.
- **Asetet joinfrastrukturore:** Asetet ku jetëgjatësia është e përcaktueshme dhe mund të pritet të nxjerrën nga përdorimi ose zëvendësohen në fund të jetëgjatësisë së tyre të pritshme. Këto asetë i nënshtrohen zhvlerësimit të kostos aktuale gjatë jetëgjatësisë së tyre të pritshme të dobishme.

- 2.20 Asetet infrastrukturore në përgjithësi përfshijnë:

- Sistemet nëntokësore të rrjeteve dhe kanalizimeve.
- Grumbullimin dhe llojet e tjera të rezervuarëve për ruajtjen e ujit të papërpunuar.
- Digat.
- Tubacionet e llumit.
- Informacionin në lidhje me asetet infrastrukturore, p.sh. të dhënat e hetimeve zonale.

- 2.21 Asetet e tjera (kryesisht mbi tokë) klasifikohen si jo infrastrukturore. Këto përfshijnë:

- Pikat e mbledhjes së ujit.
- Stacionet e pompimit.
- Impiantet e trajtimit.
- Puset.
- Tokën operationale.
- Zyrrat.
- Depot.
- Punëtoritë.
- Pronat rezidenciale, të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet operationale.
- Tokën e mbajtur, për të mbrojtur cilësinë e furnizimit me ujë të pijshëm.
- Impiantet dhe makineritë.
- Automjetet.
- Tokën e pashfrytëzueshme.
- Të gjitha asetet e tjera që nuk janë përmendur më sipër ose si infrastrukturë.

## 2.8 Shpenzimet për investime kapitale – mirëmbajtja kapitale e infrastrukturës

- 2.22 Industria e ujit dhe e ujërave të ndotura ka karakteristika që në masë të madhe e bëjnë të pavlefshëm përdorimin e zhvlerësimit, si përcaktues për shpenzimet e mirëmbajtjes kapitale të asetëve infrastrukturore për disa arsye:

- Asetet janë përgjithësisht me jetëgjatësi shumë të madhe, zakonisht më të gjatë se sa jeta e tyre kontabël. Kostoja aktuale e zëvendësimit të asetëve mund të jetë ndjeshëm më e lartë sesa kostoja fillestare e prokurimit, edhe pas llogaritjes së inflacionit.

<sup>3</sup> Për shembull, nëse shpenzimet për energji të një KRU përbëjnë 14% të kërkesës për të ardhura dhe njoftohet se një rritje prej 30% të çmimit të energjisë do të hyjë në fuqi në të ardhmen, kjo pritet të ketë ndikim mbi inflacionin në shpenzimet operative të KRU-së. Megjithatë, nëse shpenzimet për energji kanë një peshë prej 5% në IÇK-në e grumbullimit të përgjithshëm të indeksit të IÇK-së, atëherë vetëm  $[(14\%-5\%)/14\% = 64\%] \times 30\% = 19\%$  duhet të përfshihet në kërkesën për të ardhura. Kjo do të thotë, në vend që të parashikohet një rritje prej 30% në shpenzimet e energjisë, rritja në terma real do të pritej të ishte vetëm 19% dhe ky është përshkrimi që duhet të përfshihet në parashitë të ardhshme për shpenzimet operative reale.

- Jetëgjatësia e aseteve është kryesisht e papërcaktuar.
  - Shumë asete janë plotësisht (financiarisht) të zhvlerësuar, por janë ende në funksion dhe kërkojnë mirëmbajtje kapitale për të ruajtur funksionalitetin e tyre.
  - Asetet janë përgjithësisht të goposura dhe nuk janë të qasshme për inspektim për të përcaktuar jetëgjatësinë e mbetur.
  - Zhvillimet teknologjike mund të çojnë në shpenzime për zëvendësim të aseteve që ndryshojnë ndjeshëm nga asetet e vjetra, edhe pas llogaritjes së inflacionit.
- 2.23 Për këto arsye, shumica e rregullatorëve të industrisë së ujit përdorin rinovimet e infrastrukturës duke llogaritur asetet e infrastrukturës së rrjetit<sup>4</sup>.
- 2.24 Shpenzimet për mirëmbajtje kapitale të infrastrukturës përkufizohen si shpenzimet që KRU do të priste zakonisht t'i kishte çdo vit për të ruajtur nivelin ekzistues (jo të përmirësuar) të funksionalitetit të aseteve të rrjetit. Tarifë për rinovimin e infrastrukturës (TRI) që pasqyron shpenzimet e pritura për rinovimet e infrastrukturës, llogaritet çdo vit dhe përfshihet në kërkesën për të ardhura.
- 2.25 Kjo do të thotë që, në vend që të kufizohet shpenzimi për mirëmbajtje kapitale të aseteve infrastrukturore në atë që mund të përcaktohet nga një dispozitë për zhvlerësim, KRU-të duhet të përcaktojnë shpenzimet e nevojshme për të ruajtur nivelin e shërbimit dhe këto shpenzime, në thelb, do të reflektohen në tarifat në të njëjtën mënyrë si shpenzimet operative.
- 2.26 TRI përfaqëson shpenzimet e nevojshme për të ruajtur nivelet bazë të shërbimit dhe nuk përfshin shpenzimet për përmirësimin e infrastrukturës, të cilat përkundrazi shtohen në bazën rregullatore të aseteve (BRRRA). Përmirësimi i infrastrukturës përfshin shpenzimet e bëra për të mbuluar mospërputhjet historike të shpenzimeve për rinovimet e infrastrukturës, përmirësimin e cilësisë së ujit, nivelet e shërbimit dhe balancimin e kërkesë/ofertës (duke përfshirë zgjerimin e shërbimeve).
- 2.27 Grantet kapitale dhe kontributet që i atribuohen rinovimeve të infrastrukturës nuk përfshihen në kërkesën për të ardhura.

## 2.9 Shpenzimet kapitale për investime – përmirësimi i infrastrukturës

- 2.28 Investimet në përmirësimin e infrastrukturës përfshijnë:
- Zgjerimin dhe përfundimin e rrjetit- për të përmbushur kërkesën në rritje për ujë dhe gjenerimin e ujërave të ndotura nga konsumatorët shtesë dhe rritjen e konsumit të ujit dhe shkarkimeve të ujërave të ndotura nga konsumatorët ekzistues.
  - Përmirësimet në rrjet - për të ofruar një përmirësim të përhershëm të niveleve të shërbimit, p.sh. për të përmirësuar ose menaxhuar më mirë presionin në rrjet.
  - Përmirësimet në rrjet - për të ofruar një përmirësim të përhershëm të cilësisë së ujit- për të përmbushur standardet aktuale ose të reja të cilësisë së ujit, p.sh. zëvendësimi i gypave prej plumbit me gypa MDPE.
- 2.29 Investimet, pa përfshirë grantet dhe kontributet kapitale, për përmirësimin e infrastrukturës- shtohen në BRRRA. Pasi këto investime të jenë realizuar, çdo mirëmbajtje kapitale pasuese e tyre - trajtohet si rinovim i infrastrukturës.

## 2.10 Shpenzimet kapitale për asete jo infrastrukturore

- 2.30 Investimet kapitale në asete jo infrastrukturore, pa përfshirë grantet bartën në BRRRA-në jo infrastrukturore. Për qëllime të përcaktimit të tarifave, nuk është e nevojshme të bëhet dallim nëse një investim i tillë është për mirëmbajtje kapitale apo për përmirësim. Një dallim i tillë kërkohet për analizën e kërkesave dhe ende kërkohet në procesin e përcaktimit të tarifave.
- 2.31 Bazuar në analizën fillestare të BRRRA-së fillestare në vitin 2008, jetëgjatësia mesatare e dobishme e aseteve jo infrastrukturore është përcaktuar në 35 vjet. Që nga viti 2009, BRRRA jo-infrastrukturore i është nënshtruar zhvlerësimit me normën 1/35 në të gjitha përcaktimet e tarifave. Kjo normë zhvlerësimi do të zbatohet, përveç, nëse KRU-të mund të ofrojnë dëshmi të qëndrueshme për të justifikuar një normë tjetër më të përshtatshme.

<sup>4</sup> 3.2 Ofwat, rregullatori i industrisë së ujit për Anglinë dhe Uellsin shpjegon konceptin e kontabilitetit të rinovimeve të infrastrukturës në Udhëzimet e tij Kontabilitetit Rregullator 1.04 si

1.4.3 Kontabiliteti i rinovimeve të infrastrukturës përdoret për asetet e rrjetit me jetëgjatësi të gjatë (të quajtura asete infrastrukturore). Ky koncept në thelb e trajton të gjithë sasinë e aseteve individuale si një aset të vetëm infrastrukturor. Kontabiliteti i rinovimeve të infrastrukturës bazohet në vlerësimin operacional të aktiviteteve të nevojshme për të ruajtur funksionalitetin e infrastrukturës nëntokësore gjatë një periudhe afatmesme ose afatgjatë (zakonisht më shumë se 15 vjet).

- 2.32 Komponenti jo-infrastrukturor i BRRRA-së- i nënshtrohet zhvlerësimit sipas kostos aktuale me metodën e bilancit në rënie. Vlera fillestare e BRRRA-së i nënshtrohet zhvlerësimit për një vit të plotë. Investimet e reja konsiderohen të përfunduara në mes të vitit dhe i nënshtrohen zhvlerësimit prej 50% në vitin e realizimit. **Vlera mbyllëse e BRRRA-së është vlera fillestare plus shtesat, minus nxjerrja nga përdorimi dhe zhvlerësimi.** BRRRA mesatare për vitin (vlera fillestare plus vlera mbyllëse e pjesëtuar me dy) është baza për përcaktimin e kthimit nga BRRRA.
- 2.33 Zhvlerësimi i kostos aktuale realizohet përmes rivlerësimit të BRRRA-së me normën e inflacionit të IÇK-së në fund të çdo periudhe të kontrollit të çmimeve.

## 2.11 Ndikimi i investimeve kapitale në tarifa

- 2.34 Investimet në asete infrastrukturore dhe jo infrastrukturore kontribuojnë në kërkesën për të ardhura në mënyra të ndryshme.
- 2.35 Mirëmbajtja e planifikuar kapitale e grupit të asetëve infrastrukturore - kalon plotësisht në tarifa në vend që të trajtohet përmes zhvlerësimit. Si rrjedhojë, vlera e asetëve infrastrukturore ruhet përjetësisht. Shpenzimet për përmirësimin e asetëve infrastrukturore, zgjerimin/përforcimin për plotësimin e konsumit shtesë të ujit, përmirësimet në nivelin e shërbimit ose përmirësimin e cilësisë së ujit shtohen në BRRRA dhe vlera e tij e shtuar ruhet përjetësisht. BRRRA që përbëhet nga BRRRA fillestar plus çdo përmirësim (pa zbritur zhvlerësimin) i nënshtrohet indeksimit me inflacion në secilën periudhë të rishikimit të tarifave. BRRRA e indeksuar me inflacion i nënshtrohet një norme kthimi e cila bartet në kërkesën për të ardhura.
- 2.36 Mirëmbajtja e planifikuar kapitale e grupit të asetëve jo infrastrukturore i nënshtrohet zhvlerësimit të kostos aktuale që përfshihet në kërkesën për të ardhura. Shpenzimet faktike për investime kapitale në asete jo-infrastrukturore (mirëmbajtje kapitale dhe përmirësim) shtohen në BRRRA dhe indeksohen me inflacion në secilën periudhë të rishikimit të tarifave. BRRRA e indeksuar me inflacion i nënshtrohet një norme kthimi e cila bartet në kërkesën për të ardhura.
- 2.37 Kjo ilustron në Figurën 1 dhe Figurën 2 më poshtë.

### Non-infrastructure investment and revenue requirement





Figura 1 – Ndikimi i investimeve në kërkesën për të ardhura për investime jo infrastrukturore

### Infrastructure investment and revenue requirement



Note: no depreciation and RAB values maintained in perpetuity

Figura 2 – Ndikimi i investimeve në kërkesën për të ardhura për investimet infrastrukturore

## 2.12 Grantet dhe kontributet kapitale për investime

- 2.38 Grantet për investime kapitale, zakonisht paguhen nga subvencionet qeveritare ose nga agjencitë ndërkombëtare për zhvillim.
- 2.39 Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Seksioni 20, paragrafi 13, përcakton:
- 'Dy janë metodat kryesore të trajtimit kontabël të granteve qeveritare: metoda e kapitalit, sipas së cilës një grant kreditohet drejtpërsëdrejti në kapitalin aksionar dhe metoda e të ardhurave, sipas së cilës granti merret në të ardhurat për një ose më shumë periudha.'*
- 2.40 Për qasjen sipas kapitalit, kjo nënkupton që aset i financuar nga granti nuk përfshihet në regjistrin e pasurive (ose BRR) dhe për atë at aset nuk aplikohet zhvlerësimi.
- 2.41 Për qasjen sipas të ardhurave, kjo nënkupton që nëse një aset i financuar nga granti i nënshtrohet zhvlerësimit dhe përfshihet në kërkesën për të ardhura, atëherë duhet të përfshihet edhe zhvlerësimi grantit gjatë jetëgjatësisë së asetit si të ardhura të shtyra. Të ardhurat e shtyra e neutralizojnë zhvlerësimin në llogarinë e fitimeve dhe humbjeve.

- 2.42 ARRU ka miratuar qasjen sipas kapitalit. Zbatimi i qasjes sipas të ardhurave do të rezultonte në rregullime të ndërlikuara si në rezervën e grantit ashtu edhe në zhvlerësimin e grantit për të kompensuar efektet e inflacionit. Duke mos përfshirë asetit e financuar nga granti në BRRRA dhe duke mos përfshirë zhvlerësimin në kërkesën për të ardhura, procesi i përcaktimit të tarifave thjeshtohet dukshëm.<sup>5</sup>
- 2.43 Kontributet e kapitalit paguhen nga zhvilluesit dhe konsumatorët për zhvillimin e infrastrukturës që i përshtatet nevojave të veçanta të zhvilluesit ose konsumatorit, p.sh. një gyp i ri për një fabrikë, dhe për të mbuluar koston e përmirësimit të rrjetit të shpërndarjes për të përballuar kërkesën shtesë.
- 2.44 Kontributet kapitale kufizohen vetëm në kostot e çdo infrastrukture të dedikuar dhe përmirësimit të rrjetit, duke përfshirë stacionet e pompimit dhe objektet e magazinimit, por duke përjashtuar punimet në burimet ujore dhe objektet e trajtimit të ujit.
- 2.45 Rregullimi i bazës rregullatore të aseteve do të jetë kostoja e investimit neto nga çdo kontribut.

### 2.13 Tarifat për përforsimin e infrastrukturës

- 2.46 ARRU ka prezantuar tarifën për përforsimin e infrastrukturës jashtë vendit. Këto janë tarifa që pasqyrojnë efektin kumulativ afatgjatë të konsumatorëve të rinj neto, që nxisin nevojën për përforsimin e infrastrukturës. ARRU konsideron se ky përforsim nuk duhet të financohet nga baza ekzistuese e konsumatorëve përmes tarifave, por më shumë nga zhvilluesit që krijuan nevojën për një përforsim të tillë.
- 2.47 Tarifa e përforsimit të infrastrukturës është një kontribut kapital për përmirësimin e infrastrukturës. Kjo nënkupton se shtesa në BRRRA për përmirësimin e infrastrukturës do të jetë neto nga tarifën e përforsimit të infrastrukturës jashtë vendit. Kur të ardhurat nga tarifën e përforsimit të infrastrukturës janë më të mëdha se shpenzimet vjetore për përmirësimin e infrastrukturës, BRRRA do të reduktohet, duke u trajtuar në mënyrë efektive si një paradhënie kundrejt investimeve të ardhshme për përmirësim.
- 2.48 Me kalimin e kohës, **vlera aktuale neto e të ardhurave nga tarifën e përforsimit të infrastrukturës duhet të barazohet me vlerën aktuale neto të shpenzimeve për përmirësimin e infrastrukturës që i atribuohet konsumatorëve të rinj, duke përjashtuar shpenzimet e përmirësimit që i atribuohen niveleve të përmirësuar të shërbimit ose cilësisë.**

### 2.14 Baza rregullatore e aseteve (BRRRA)

- 2.49 BRRRA përfaqëson bazën e kapitalit, mbi të cilën KRU-të kanë të drejtë për kthim. Ajo përfaqëson nivelin e investimeve të bëra, të financuara nga burimet financiare vetanake të KRU-ve, investimet në kapital dhe përmes kredive.
- 2.50 BRRRA përcaktohet nga vlera fillestare (2009) dhe shpenzimet kapitale pasuese neto të zhvlerësimit dhe granteve dhe kontributeve, të indeksuara në nivelet e çmimeve të vitit bazë.
- 2.51 BRRRA rregullohet në çdo rishikim të tarifave për të përfshirë shtesat (investimet e reja), zbritjet (zhvlerësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit) dhe rregullohet nga indeksat e inflacionit për të kaluar nga një vit bazë rishikimi në nivelin e çmimeve në vitin tjetër bazë. Kjo shpjegohet më hollësisht në udhëzimet e kontabilitetit rregullator (UKRR).
- 2.52 Vlera fillestare e bazës rregullatore të aseteve në vitin bazë është një input në modelin financiar.
- 2.53 Shpenzimet kapitale për investimet jo-infrastrukturore shtohen në bazën rregullatore të aseteve dhe zhvlerësimi i koston aktuale zbritet nga baza rregullatore e aseteve.
- 2.54 Shpenzimet për rinovimin e infrastrukturës nuk shtohen në bazën rregullatore të aseteve.
- 2.55 Shpenzimet për përmirësimin e infrastrukturës shtohen në bazën rregullatore të aseteve.
- 2.56 Kapitali qarkullues konsiderohet të jetë i përfshirë në bazën rregullatore të aseteve dhe nuk do të bëhen rregullime për ndryshimet në kapitalin qarkullues.

<sup>5</sup> Ofwat, rregullatori i sektorit të ujit për Anglinë dhe Uellsin, aplikon qasjen e të ardhurave për investimet e financuara nga grantet. Udhëzimet e kontabilitetit rregullator të Ofwat në këtë drejtim janë të ndërlikuara, veçanërisht sa i përket rivlerësimit të rezervës së grantit dhe zhvlerësimit të grantit.

## 2.15 Kthimi nga baza rregullatore e aseteve

- 2.57 Kthimi nga kapitali bazohet në një kthim 'të drejtë' që pasqyron koston e kapitalit për ofruesit rajonalë të shërbimeve të ujit (normat e interesit dhe pritshmërinë e kthimit nga kapitali).
- 2.58 ARRU aplikon modelin e çmimit të aseteve kapitale, për aq sa është e mundur brenda kontekstit të tregjeve financiare të Kosovës, për të përcaktuar normën ose kthimin që është i përshtatshëm për sektorin e ujit në Kosovë.
- 2.59 Kthimi i aplikuar është një kthim 'real', pra duke përfshirë inflacionin. Efektet e inflacionit përfshihen në tarifa përmes indeksimit të BRRRA-së në çdo rishikim të tarifave, aplikimit të zhvlerësimit të kostos aktuale dhe indeksimit të tarifave të përcaktuara brenda një periudhe të kontrollit të çmimeve. E gjithë kjo është në përputhje me teorinë ekonomike konvencionale dhe siç zbatohet nga rregullatorët në shumë sektorë në shumë shtete.
- 2.60 Kthimi aplikohet në mesataren e BRRRA-së të çdo viti dhe i shtohet kërkesës për të ardhura.

## 2.16 Pajtimi i investimeve aktuale dhe atyre të planifikuara në të kaluarën (rikthimi i investimeve)

- 2.61 Duke filluar nga periudha e përcaktimit tarifor 2029-2031, procesi do të përfshijë një dispozitë, ku ndikimi tarifor i investimeve të kaluara të përfshira në përcaktimin paraprak të tarifave, të cilat nuk janë zbatuar, ose janë përfunduar me vonë, do t'u kthehen konsumatorëve në përcaktimin aktual të tarifave. Kjo, gjithashtu, mund të rezultojë në tarifa më të larta për konsumatorët, nëse vlera e investimeve tejkalon atë që ishte planifikuar, ose është përfunduar më herët..
- 2.62 Ndikimi në tarifa do të përfshijë:
- Vlerën totale të investimeve për rehabilitim të infrastrukturës, më pak e realizuar ose e realizuar më tepër.
  - Kthimin në BRRRA për investimet infrastrukturore më pak të realizuara ose të realizuara më tepër.
  - Kthimin në BRRRA për investimet jo-infrastrukturore më pak të realizuara ose të realizuara më tepër.
  - Zhvlerësimi aktual i kostos që lidhet me investimet më pak të realizuara ose të realizuara më tepër.
  - Kostoja e mundshme e të ardhurave shtesë të pafituara të përcaktuara me normën reale të kthimit që zbatohet në BRRRA.

## 2.17 Shitjet e ujit për përcaktimin e tarifave të bazuara në vëllim

- 2.63 Projektionet e përgjithshme të shitjeve janë të bazuara në planet afariste të KRU-ve, por i nënshtrohen kontrollit rregullator dhe, sipas rastit, bëhen rregullime për të pasqyruar pritjet e ARRU-së për përmirësimin e performancës.
- 2.64 Shitjet totale vjetore të pritura të ujit (m3) përcaktohen mbi bazën e vlerësimeve më të mira të KRU-ve për vëllimin e shitjeve të ujit duke marrë parasysh kërkesat aktuale dhe të ardhshme për ujë, pritshmëritë reale por gjithsesi sfiduese për rritjen e shitjeve të regjistruara me ujëmatës përmes programeve të riparimit dhe zëvendësimit të ujëmatësve dhe rregullimin e konsumatorëve aktualë që nuk janë regjistruar. Rritja e shitjeve nga riparimet dhe zëvendësimet e ujëmatësve dhe rregullimi i konsumatorëve aktualë të paregjistruar janë masat kryesore përmes të cilave humbjet dukshme do të reduktohen. ARRU pret përmirësime të konsiderueshme në shitje që rezultojnë nga këto aktivitete.
- 2.65 Vëllimet e shitjeve të ujit do të bëjnë dallimin ndërmjet shitjeve totale të ujit dhe shitjeve të ujit për konsum me lidhje të ujërave të ndotura, që është bazë për përcaktimin e tarifave të shërbimeve të ujërave të ndotura.
- 2.66 Shitjet e ujit të vlerësuara me qëllim të caktimit të tarifave për ujërat e ndotura, do të përcaktohen për ata konsumatorë ku vëllimi i ujërave të ndotura të gjeneruara nuk lidhet me hyrjen e ujit nga KRU.
- 2.67 Projektionet e shitjeve të ujit do të ndahen në kategori të konsumatorëve: shtëpiak dhe jo-shtëpiak. KRU-të do të sigurojnë informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar vlerësime të arsyeshme për këto projekte sipas kategorive.

- 2.68 Numri i parashikuar i klientëve (sipas kategorisë) për çdo vit kërkohet për të përcaktuar bazën mbi të cilën përcaktohen të ardhurat nga tarifat e kyçjes, të ardhurat nga tarifat fikse dhe të ardhurat nga tarifat e përforsimit të infrastrukturës jashtë vendit.
- 2.69 Projektionet e shitjeve të ujit sipas kategorive do të rregullohen për të pasqyruar borxhet e pakthyeshme (mos pagesa). Rregullimet për borxhet e pakthyeshme do t'i nënshtrohen shqyrtimit të ARRU-së, në përcaktimin e një niveli të përshtatshëm të borxhit të pakthyeshëm.

## 2.18 Strukturat e tarifave

- 2.70 Strukturat e tarifave për ujë përfshijnë:
- Tarifën fikse mujore për konsumator, e cila nga viti 2026 do të bazohet në madhësinë e kyçjes.
  - Tarifën volumetrike të ujit për m<sup>3</sup> të shitur, (aktualisht janë të aplikueshme tarifa të ndryshme volumetrike për konsumatorët shtëpiak dhe jo-shtëpiak).
  - Tarifën për ekzekutimin fizik të instalimeve për lidhjet e reja.
  - Tarifën për përforsimin e infrastrukturës, për kyçjet e reja neto të ujit.
- 2.71 Struktura e tarifave për shërbimet e ujërave të ndotura përfshin:
- Tarifën volumetrike të ujërave të ndotura për m<sup>3</sup> të ujit të shitur, (për ata konsumatorë që kanë kyçje për ujërat e ndotura - aktualisht aplikohen tarifa të ndryshme për konsumatorët shtëpiak dhe jo-shtëpiak).
  - Tarifën shtesë për ujërat e ndotura - për ata konsumatorë që janë subjekt i tarifave për konsumatorët biznes-industri, kur cilësia e ujërave të ndotur në përbërje është më e ndryshme nga cilësia mesatare e ujërave të ndotura (opsionale).
  - Tarifën fikse mujore për konsumatorë që marrin vetëm shërbimet e ujërave të ndotur.
  - Tarifën për ekzekutimin fizik të instalimeve për lidhjet e reja.
  - Tarifën për përforsimin e infrastrukturës - për kyçjet e reja të ujërave të ndotura.
- 2.72 Tarifat shtesë (ose zbritjet) për ujërat e ndotura nga bizneset/industria për konsumatorët që kualifikohen përcaktohen duke përdorur formulën e Mogden, detajet e së cilës janë të dhëna në Udhëzimet e ARRU-së për tarifat e ujërave të ndotura industriale të publikuara në janar 2025.

## 3 Metoda e përcaktimit të tarifave

---

### 3.1 Kërkesa për të ardhura

- 3.1 Përcaktimi i tarifave për ujë, bazohet në çmimet e përcaktuara për të përmbushur kërkesat e të ardhurave për secilën KRU. Kjo kërkesë për të ardhura përfshin:
- Shpenzimet operative: kostot e shërbimit (blerjet e ujit), punën, energjinë, materialet shpenzuese, kimikatet, shpenzimet e përgjithshme, taksat e pakthyeshme dhe shpenzimet e përsëritura
  - Mirëmbajtjen kapitale: tarifat e rinovimit të infrastrukturës dhe zhvlerësimin e kostos aktuale
  - Kthimi nga BRR: një kthim i drejtë nga baza rregullatore e asetëve të financuara nga KRU-të.
  - Zvogëlimi (kthimi i investimeve të pa realizuara) i të ardhurave tarifore të paguara nga konsumatorët për investimet e përfshira në përcaktimet e kaluara tarifore, që nuk janë realizuar ose realizuar me vonesë. Kjo vlerë mund të jetë pozitive nëse bilanci tregon investime më shumë të realizuara ose të përfunduara më herët.
- 3.2 Kërkesa për të ardhura përfshihet në paraqitjen e planit të biznesit. Ajo rrjedh nga projektionet e shpenzimeve të ardhshme të nevojshme për të përmbushur obligimet e nivelit të shërbimit të KRU-ve.

### 3.2 Çmimet reale

- 3.3 Të gjithë zërat e shpenzimeve, futen në parashitje, në nivelet reale të çmimeve të mesit të vitit bazë, ku viti bazë është viti që i paraprin vitit të parë të periudhës së kontrollit të çmimeve. Për rrjedhojë, rezultatet e tarifave janë gjithashtu në nivelet e çmimeve të mesit të vitit bazë.

- 3.4 Tarifa aktuale e aplikuar për çdo vit të periudhës së kontrollit të çmimeve (viti n) do të jetë tarifa e nivelit të çmimit të vitit bazë, e rregulluar nga inflacioni i shfaqur gjatë periudhës qershor-qershor të dy viteve të mëparshme<sup>6</sup>, d.m.th

$$\text{Tarifa për vitin } n = \frac{(\text{Tarifa e vitit bazë për vitin } n) \times (\text{Indeksi i inflacionit i qershorit të viti } n-1)}{(\text{Indeksi i inflacionit i qershorit të vitit } n-2)}$$

dhe

$$\text{Tarifa për vitin } n+1 = \frac{(\text{Tarifa e vitit bazë për vitin } n+1) \times (\text{Indeksi i inflacionit i qershorit të viti } n)}{(\text{Indeksi i inflacionit i qershorit të vitit } n-2)}$$

dhe

$$\text{Tarifa për vitin } n+2 = \frac{(\text{Tarifa e vitit bazë për vitin } n+2) \times (\text{Indeksi i inflacionit i qershorit të viti } n+1)}{(\text{Indeksi i inflacionit i qershorit të vitit } n-2)}$$

- 3.5 Ky proces i rregullimit të indeksimit zbatohet për të gjitha tarifat dhe tarifat e përcaktuara duke përfshirë tarifat e bazuara në vëllim, tarifat fikse, tarifat shtesë të cilësisë së ujërave të ndotura, tarifat për kyçe, tarifat për përmirësimin e infrastrukturës etj.

### 3.3 Shqyrtimi i propozimeve nga ARRU

- 3.6 Modeli i përcaktimit të tarifave është përmirësuar, për të përfshirë një veçori që mundëson që paraqitja e kërkesave nga KRU-të dhe rezultateve të ndryshimeve nga ARRU pas shqyrtimit të shihen paralelisht. Kjo ia mundëson përdoruesit të shohë menjëherë rezultatet e shqyrtimit nga ARRU.

### 3.4 Llogaritja dhe përcaktimi i tarifave

#### Furnizimi me ujë

- 3.7 Kërkesa për të ardhura për shërbimet e furnizimit me ujë ( $R_{Wn}$ ) për çdo vit të periudhës së shqyrtimit tarifar llogaritet si:

$$R_{Wn} = \Sigma O_{Wn} + \Sigma M_{Wn} + \Sigma P_{Wn} - C_{Wn}, \text{ ku}$$

$R_{Wn}$  = Kërkesa për të ardhura nga furnizimi me ujë në vitin n.

$\Sigma O_{Wn}$  = Shuma e shpenzimeve të parashikuara operative të furnizimit me ujë në vitin n.

$\Sigma M_{Wn}$  = Shuma e shpenzimeve të parashikuara për mirëmbajtje kapitale të furnizimit me ujë në vitin n (e cila plotësohet nëse përtëritja e projektuar e infrastrukturës përfshin shpenzimet plus zhvlerësimin e kostos aktuale për asetet jo infrastrukturore). Referojuni UKRR-së për detaje të mëtejshme.

$\Sigma P_{Wn}$  = Kthimi nga UKRR për furnizim me ujë për vitin n.

$C_{Wn}$  = Provizioni vjetor për kthimin e parave të paguara nga konsumatorët për investimin në furnizimin me ujë gjatë periudhës së shqyrtimit tarifar të mëparshëm dhe që nuk janë realizuar. Kjo nuk zbatohet për përcaktimin e tarifave për periudhën 2026-2028, por do të zbatohet për periudhën pasuese të shqyrtimit tarifar.

- 3.8 Tarifat e furnizimit me ujë përbëhen nga disa komponentë:

- $T_{WF}$  = Tarifa mujore fikse bazuar në madhësinë e kyçjes. ARRU ka propozuar se cilat duhet të jenë këto tarifa (në nivelet e çmimeve të vitit bazë 2025), por KRU-të janë të lira të propozojnë tarifa alternative për sa kohë që paraqesin prova që mbështesin propozimet e tyre. Kjo tarifë aplikohet për konsumatorët e furnizimit me ujë dhe për konsumatorët që marrin vetëm shërbime të ujërave të ndotura.
- $T_{WVD}$  = Tarifa volumetrike për m<sup>3</sup> të ujit të furnizuar për konsumatorët shtëpiak.
- $T_{WVN}$  = Tarifa volumetrike për m<sup>3</sup> të ujit të furnizuar për konsumatorët jo-shtëpiak.
- $T_{WVB}$  = Tarifa volumetrike për m<sup>3</sup> të ujit të furnizuar për konsumatorët me shumicë (siç është Mitrovica e Veriut dhe për transportin e ujit nga një KRU në tjetrën).

<sup>6</sup> Përdorimi i indekseve të inflacionit për vitet e mëparshme është një qasje standarde rregullatore për konvertimin e çmimeve reale në çmime nominale. Kjo është e nevojshme pasi të dhënat për inflacionin aktual për periudhën nuk janë të disponueshme deri pas aplikimit të tarifave. Edhe pse mund të argumentohet se kjo krijon një pasaktësi në procesin e konvertimit, këto pasaktësi janë minimale dhe në mënyrë efektive anulohen me kalimin e kohës.

- $T_{WC}$  = Tarifat për ekzekutimin fizik të instalimeve të furnizimit me ujë.
  - $T_{WI}$  = Tarifa për përforcimin e infrastrukturës të furnizimit me ujë për lidhjet e reja neto.
- 3.9  $T_{WF}$ ,  $T_{WC}$  dhe  $T_{WI}$  janë të gjitha tarifat e paracaktuara që vendosen jashtë modelit dhe janë inpute të modelit (në nivelet e çmimeve të vitit bazë)
- 3.10 Kërkesa për të ardhura neto, nga tarifa volumetrike e ujit në vitin n ( $netR_{Wn}$ ) përcaktohet duke zbritur të ardhurat nga tarifatat për kyçje në vitin n ( $\Sigma T_{WCn}$ ) dhe të ardhurat nga tarifatat fikse mujore ( $\Sigma T_{WFn}$ ) nga kërkesa totale e të ardhurave ( $R_{Wn}$ ), d.m.th
- $$netR_{Wn} = R_{Wn} - \Sigma T_{WFn} - \Sigma T_{WCn}$$
- 3.11 Të ardhurat nga tarifa për përforcimin e infrastrukturës jashtë vendit, për kyçjet e reja neto ( $T_{WI}$ ), nuk zbriten nga kërkesa për të ardhura pasi këto të ardhura janë një kontribut për përmirësimin e infrastrukturës dhe kalohen si reduktim në komponentin e infrastrukturës së BRRR-së.
- 3.12 Kjo kërkesë për të ardhura neto, për çdo vit pjesëtohet me vëllimin ekuivalent të brendshëm të shitjeve për çdo vit ( $\Sigma Q_{WDEn}$ ) për të arritur në tarifën e vëllimit për konsumatorët shtëpiak, d.m.th
- $$T_{WVDn} = netR_{Wn} / \Sigma Q_{WDEn}, ku,$$
- $$\Sigma Q_{WDEn} = \Sigma Q_{WD} + \Sigma Q_{WN} \times CS_{Wn} + \Sigma Q_{WBn} \times BF_{Wn}, ku$$
- $\Sigma Q_{WDn}$  = Vëllimi total i shitjeve të ujit për konsumatorët shtëpiak për vitin n
- $\Sigma Q_{WNn}$  = Vëllimi total i shitjeve të ujit për konsumatorët jo-shtëpiak për vitin n
- $CS_{Wn}$  = Faktori i ndër-subvencionit të furnizimit me ujë për vitin n
- $\Sigma Q_{WBn}$  = Vëllimi total i shitjeve të ujit me shumicë për viti n, dhe
- $BF_{Wn}$  = Faktori i furnizimit me ujë me shumicë për vitin n (përqindja e tarifës së konsumit shtëpiak që duhet të zbatohet për shitjet e ujit me shumicë.)
- 3.13 Pas përcaktimit të tarifës për furnizim për konsumatorët shtëpiak, tarifatat për konsumatorët jo-shtëpiak dhe për furnizim me ujë me shumicë përcaktohen duke shumëzuar tarifatat për konsumatorët shtëpiak me faktorët e ndër-subvencionimit dhe furnizimit me ujë me shumicë, d.m.th.
- $$T_{VWVDn} = T_{WVDn} \times CS_n, dhe$$
- $$T_{VWB} = T_{WVDn} \times BF_n$$

#### Shërbimet e ujërave të ndotura

- 3.14 Procesi i përcaktimit të tarifave për shërbimet e ujërave të ndotura është i ngjashëm, por përfshin aspektet siç janë tarifatat e bazuara në cilësinë e ujit dhe rrjedhat e vlerësuarat të ujërave të ndotura në rastet kur vëllimi i krijuar i ujërave të ndotura nuk lidhet me sasinë e ujit të furnizuar.
- 3.15 Kërkesa për të ardhurat nga shërbimet e ujërave të ndotura (kanalizimeve) ( $R_{Sn}$ ) për çdo vit të periudhës së kontrollit të çmimit llogaritet si:
- $$R_{Sn} = \Sigma O_{Sn} + \Sigma M_{Sn} + \Sigma P_{Sn} - C_{Sn}, ku$$
- $R_{Sn}$  = Kërkesa për të ardhura nga shërbimet e ujërave të ndotura në vitin n.
- $\Sigma O_{Sn}$  = Shuma e shpenzimeve operative të parashikuara për shërbimet e ujërave të ndotura në vitin n.
- $\Sigma M_{Sn}$  = Shuma e kërkesave të parashikuara për mirëmbajtje kapitale të shërbimeve të ujërave të ndotura në vitin n (e cila plotësohet nëse rinovimi i projektuar i infrastrukturës përfshin shpenzimet plus zhvlerësimin e kostos aktuale për asetet jo infrastrukturore). Referojuni UKRR-së për detaje të mëtejshme.
- $\Sigma P_{Sn}$  = Kthimi nga UKRR për shërbimet e ujërave të ndotura për vitin n.
- $C_{Sn}$  = Provizioni vjetor për kthimin e parave të paguara nga konsumatorët në periudhën paraprake të kontrollit të çmimit për investimet në shërbimet e ujërave të ndotura që nuk janë realizuar. Kjo nuk zbatohet për përcaktimin e tarifave për periudhën 2026-2028, por do të zbatohet për periudhat e kontrollit të tarifave të ardhshme.

- 3.16 Tarifat për shërbimet e ujërave të ndotura përbëhen nga disa komponentë:
- $T_{SVD}$  = Tarifa volumetrike për  $m^3$  të ujit të furnizuar për konsumatorët shtëpiak të lidhur me shërbimin e ujërave të ndotura.
  - $T_{SVN}$  = Tarifa volumetrike për  $m^3$  të ujit të furnizuar për konsumatorët jo-shtëpiak të lidhur me shërbimin e ujërave të ndotura, duke përfshirë vlerësimin e shkarkimeve të ujërave të ndotur, ku shkarkimi i ujërave të ndotura nuk është e lidhur me furnizimin me ujë.
  - $T_{SVT}$  = Tarifat shtesë (ose zbritjet) që janë të aplikueshme për konsumatorët e Kategorisë T1 dhe Kategorisë T2 për tarifrat e ujërave të ndotura industriale.
  - $T_{SC}$  = Tarifat për ekzekutimin fizik të instalimeve të reja në shërbimet e ujërave të ndotura.
  - $T_{SI}$  = Tarifa për përmirësimin e infrastrukturës për shërbimet e ujërave të ndotura për lidhjet e reja neto.

3.17 TSC dhe TSI janë të gjitha tarifrat e paracaktuara që vendosen jashtë modelit dhe janë inpute të modelit (në nivelet e çmimeve të vitit bazë)

3.18 Kërkesa për të ardhura neto nga tarifa për shërbimet e ujërave të ndotura në vitin  $n$  ( $netR_{Sn}$ ) përcaktohet duke zbritur të ardhurat nga tarifrat për kyçje në vitin  $n$  ( $\Sigma TSC_n$ ) dhe të ardhurat nga tarifrat shtesë për ujërat e ndotura industriale (ose zbritjet) ( $\Sigma T_{SVTn}$ ) nga kërkesa totale e të ardhurave ( $R_s$ ), d.m.th

$$netR_{Sn} = R_{Sn} - \Sigma T_{WCn} - \Sigma T_{SVTn}$$

3.19 Të ardhurat nga tarifa e përforcimit të infrastrukturës jashtë lokacionit për kyçjet e reja neto (TSI) nuk zbriten nga kërkesa për të ardhura pasi këto të ardhura janë një kontribut për përmirësimin e infrastrukturës dhe kalohen si një reduktim në komponentin e infrastrukturës së BRRR-së.

3.20 Kjo kërkesë për të ardhura neto për çdo vit pjesëtohet me vëllimin ekuivalent të brendshëm të shitjeve për çdo vit ( $\Sigma Q_{SDEn}$ ) për të arritur në tarifën e vëllimit për konsumatorët shtëpiak, d.m.th

$$T_{SVDn} = netR_{Sn} / \Sigma Q_{SDEn}, \text{ where,}$$

$$\Sigma Q_{SDEn} = \Sigma Q_{SD} + \Sigma Q_{SN} \times CS_{Sn}, \text{ ku}$$

$\Sigma Q_{SDn}$  = Vëllimi total i shitjeve të ujit për konsumatorët shtëpiakë të lidhur me shërbimin e ujërave të ndotura për vitin  $n$ .

$\Sigma Q_{SNn}$  = Vëllimi total i shitjeve të ujit për konsumatorët jo-shtëpiakë të lidhur me shërbimin e ujërave të ndotura, duke përfshirë hyrjen shtesë të ujit të vlerësuar bazuar në rrjedhjet e vlerësuara të ujërave të ndotura ku rrjedhja e ujërave të ndotura nuk lidhet me furnizimin me ujë për vitin  $n$ .

$CS_{Wn}$  = Faktori i ndër-subvencionit të shërbimeve të ujërave të ndotura për vitin  $n$ .